



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: _____

Nr: ____

Ora: __:__

PROJEKTVENDIM

PËR

KRIJIMIN E KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT TË POSAÇME NR. 1422/02, PRANË IEVP DURRËS DHE AUTORIZIMIN E KZAZ-SË NR. 23 PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË TIJ, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 43, nenit 62, pika 2 dhe nenit 93, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 23, Qarku Durrës, me vendimin nr. 03, datë 04.04.2025, i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, krijimin e Komisionit të Qendrës së Votimit të Posaçme nr. 1422/02, të IEVP Durrës.

Bashkia Durrës i ka dërguar KZAZ-së nr. 23, listën emërore të zgjedhësve të IEVP, në total 192 zgjedhës të dënuar, ndërkohe që në ekstraktin e Gjendjes Civile rezulton të jenë 195 zgjedhës të dënuar.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të autorizojë KZAZ nr. 23, Bashkia Durrës, që të krijojë komisionin e kësaj qendre votimit dhe të marrë masat për të siguruar infrastrukturën e nevojshme, sikundër të gjitha qendrat e tjera të votimit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 43, nenin 62, pika 2, nenin 93, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Autorizimin e KZAZ-së nr. 23, Qarku Durrës, që të krijojë dhe emërojë me vendim Komisionin e Qendrës së Votimit të Posaçme nr. 1422/02, IEVP Durrës.

Data: DD MM VVVV Nr: 00 00
Ora: HH:MM



Për krijimin e Komisionit të Qendrës së Votimit të Posaçme nr. 1422/02, pranë IEVP Durrës dhe autorizimin e KZAZ-së nr. 23 për emërimin e anëtarëve të tij, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: DD MM VVVV Nr: 00 00
Ora: HH:MM



Për krijimin e Komisionit të Qendrës së Votimit të Posaçme nr. 1422/02, pranë IEVP Durrës dhe autorizimin e KZAZ-së nr. 23 për emërimin e anëtarëve të tij, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025